

ARDAEL SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

## **INFORMACION I PËRGJITHSHËM DHE PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL**

## 1. Të përgjithshme

Shoqëria tregtare " ARDAEL " sh.p.k. është themeluar në datë 02/08/2012 dhe rregjistruar në QKB në datë 03/08/2012, me forme ligjore shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria ka si aktivitet kryesor të saj: Ekzekutimi i tituve ekzekutiv (Sherbim Permbarimor).

Kapitali i shoqërisë është 100.000 lekë dhe pjesët e saj zotërohen 100% nga ortaku i vetem i saj z.Ardian Elezi.

Adresa e shoqërisë është: Rruga Xhorxh W Bush, Tiranë.

## **2. Bazat e përgatitjes**

(a) Deklarata për pajtueshmëri

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

### (b) Bazat e maties

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në LEK e cila eshte monedha funksionale e shqerise.

### 3 Politikat kontahël të rendësishme

(a) Transaksjonet ne monedha të huaja

Transaksionet në monedhat e huaja janë perkthyer me kursin e kembimit te datës së transaksionit. Aktivet monetare në monedha te huaja janë perkthyer në LEK me kursin ne ditën e mbylljes së bilancit. Diferencat e konvertimit si pasojë e përkthimit të monedhave te huaja në Leke janë përfshirë në fitim humbje. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë raportuar me kursin historik të monedhës së huaj në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhe te huaj te ylerësuara me vlerën e drejtë janë përkthyer në LEK me kursin e monedhës së huaj në datën e bilancit.

Kurset e kembimit janë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
1 EUR	123.42	132.95
1 USD	107.82	111.10

## ARDAEL SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

---

(Shumat janë shprehur në Lek, përvèç rastit kur specifikohet monedha tjeter)

### (b) Instrumentat financiare

Shoqeria zotëron instrumenta financiare që përfshijnë llogari klientesh, mjete monetare, dhe llogari të tjera për tu paguar apo për tu arkëtuar me karakter tregetar. Llogarite e arketueshme dhe depozitat, njihen fillimi si ne daten e krijimit te tyre. Te gjithe instrumentet e tjere financiare (perfshi dhe ata me vlerë te drejte nepermjet te ardhurave dhe shpenzimeve), njihen fillimi si ne daten kur shoqeria behet pale kontraktuale e nje instrumenti.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në dorë, depozitat në banka, investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi me pak se tre muaj te cilat nuk janë subjekt i riskut te ndryshimit të vlerës se drejtë dhe përdoren nga Shoqeria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Ato vlerësohen me vlerën nominale.

#### *Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera te arketueshme*

Llogaritë e klientëve dhe llogari të tjera të arkëtueshme janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

#### *Llogarite e furnitoreve dhe të tjera llogari të pagueshme*

Llogaritë e furnitoreve dhe te tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjere financiare janë vlerësuar me koston e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

### (c) Inventarët

Inventarët maten fillimi me kostos. Inventarët janë materiale të konsumueshme dhe në fund të vitit rezultojnë pa gjendje.

### (d) Aktivet Afatgjata Materiale

#### (i) Njohja dhe matja

Aktivet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me kostos minus amortizimin e akumuluar sipas SKK 5 "Aktivet AA Materiale dhe AA Jomateriale".

#### (ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese përbërëse të një prej aktiveve materiale afatgjata, njihet në vlerën e mbartur të aktivit, nëse është e mundur që Shoqeria do të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga ky veprim dhe kostojë e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e shërbimeve të përditëshme të aktiveve material afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.



## ARDAEL SHPK

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë shprehur në Lek, përvçe rastit kur specifikohet monedha tjeter)

### (iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet sipas normave fiskale, të cilat në formën e përqindjeve paraqiten si më poshtë:

- Mobilje dhe Paisje zyre.....20%
- Paisje informatike.....25%
- Mjete transporti (autoveture).....20%

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga dëmtimi ose dalja jashtë përdorimit e një aseti, përcaktohen nga diferenca ndërmjet vlerës së përfituar të realizuar dhe vlerës së mbetur kontabël të asetit dhe kjo vlerë njihet si e ardhur apo shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### (e) Zhvlerësimi i aktiveve

#### (i) Aktivet financiare

Aktivet financiare vleresohen ne çdo datë të raportimit për të përcaktuar në se ka ndonjë evidencë objektive për zhvlerësim. Një aktiv finanziar zhvlerësohet në se ka evidencë objektive që tregon se ka ndodhur një ngjarje humbjeje pas njoftes fillestare të aktivit që ndikon negativisht flukset e ardhshme monetare te vlerësuara për këtë aktiv dhe nëse këto flukse mund të maten me besueshmëri.

Humja nga zhvlerësimi i një aktivit finanziar të matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferenca mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të skontuara me interesin efektiv. Humbjet njihen si në llogaritë e fitim/humbjeve ashtu dhe në llogaritë e zbritjeve të arkëtueshmeve.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen individualisht për zhvlerësim. Pjesa tjeter e aktiveve grupohen sipas karakteristikave të riskut të kredisë dhe vlerësohen në grup. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në llogaritë e fitim humbjes.

Kur një ngjarje e mëpasshme ul shumën e njoftur të humbjes nga zhvlerësimi, ulja e humbjes nga zhvlerësimi rimerret në llogaritë e fitim humbjes.

#### (ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbartur e aktiveve jo-financiare me perjashtim te taksave te shtyra, rishikohet ne çdo periudhe raportuese per te percaktuar nese ka ndonje indikator per zhvlerësim. Nese ekziston ndonje indikacion i tillë, atehere behet vleresimi i shumes se rikuperueshme te aktivit. Ne kete menyre një humbje nga zhvlerësimi regjistrohet nese vlera e mbartur ne kontabilitet e ketij aseti e tejkalon vleren e rikuperueshme. Keto humbje nga zhvlerësimi pasqyrohen ne pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një aktivit percaktohet si me e madhja midis vleres se tij te përdorimit dhe vleres se drejtë minus kostot e shitjes. Ne percaktimin e vleres se përdorimit, parashikimi i flukseve monetare skontohet per te aritur tek vlera aktuale duke përdorur normat e skontimit perpara taksave që reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe te rreziqeve specifike te ketij aktivi.

Humbjet nga zhvlerësimi të regjistruar në periudhat e meparshme rivleresohen ne çdo periudhe raportuese per te pare ndonje indikator nese keto humbje janë zvogeluar ose nuk ekzistojne më. Nje humbje nga zhvlerësimi rishikohet ne se ka ndonje ndryshim te parashikimeve te bera ne percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga rivleresimi rishikohet deri ne ate mase sa vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vleren e mbartur neto nga amortizimi, nese kjo humbje nuk do te ishte regjistruar fare.

### (f) Kostot e huamarrjes

Shoqëria njeh të gjitha kostot e huamarrjes si shpenzim në periudhën në të cilën ato janë kryer.

**ARDAEL SHPK**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

*(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjeter)***(g) Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe kryerja e shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të kompanise. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet.

**(h) Njohja e shpenzimeve**

Shpenzimet janë njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Te ardhurat dhe shpenzimet janë njohur sipas metodes se konstatimit te te drejtave dhe detyrimeve. Shpenzimet janë njohur ne vitin ushtrimor si dhe te ardhurat qe lidhen me to (procesi i perputhjes se te ardhurave me shpenzimet).

**(i) Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat nga interesat per llogarite bankare, dhe perfimet nga diferenca e kembimit. Interesat njihen ashtu siç perllogariten duke perdonur metoden e interesit efektiv. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet per interesa dhe humbjet nga diferenca e kembimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen në baza neto.

**(j) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin paraqitet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përjashtuar rastet kur lidhet me zërat e kapitalit e përrnjedhim paraqitet në kapital.

Tatimi është tatimi i parashikuar për tu paguar, i përllogaritur mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke perdonur normat tatimore në fuqi (15 %) në datën e bilancit si dhe cdo korrigjim të tatimit të pagueshëm të periudhave të mëparshme.

Tatimi i shtyre njihet si pasojë e diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qellime te raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qellime tatimore.

Nje aktiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferenca e përkohëshme të zbritshme, humbjet tatimore dhe kreditimet tatimore të papërdorura, për aq sa ato kanë mundësi të mbulohen nga përfimet e ardhshme tatimore. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në cdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në masën që ka mundësi që të realizohet përfitimi tatimor.

**SHËNIME MBI ZËRAT E PASQYRAVE FINANCIARE****4 Mjete Monetare**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Banka	6,336,022	8,755,444
Arka	19,098	7,434
<b>Totali</b>	<b>6,355,120</b>	<b>8,762,878</b>

**5 Të drejta të arkëtueshme**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	2,272,609	7,628,403
<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>	-	-
<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	-	-
<i>Të tjera</i>	321,397	4,113,140



**ARDAEL SHPK**

**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018**

(*Shumat janë shprehur në Lek, përvèç rastit kur specifikohet monedha tjetër*)

<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>	<b>2,594,006</b>	<b>11,741,543</b>
<b>Totali</b>	<b>2,594,006</b>	<b>11,741,543</b>
<b>6 Aktive materiale</b>		
	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<i>Toka dhe ndërtesa</i>	-	-
<i>Impiente dhe makineri</i>	1,652,702	2,065,877
<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	605,257	747,769
<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>	-	-
<b>Totali</b>	<b>2,257,958</b>	<b>2,813,646</b>
<b>7 Detyrime afatshkurtra</b>		
	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<i>Titujt e huamarrjes</i>	-	-
<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	-	-
<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	-	-
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	-	-
<i>Dëftesa të pagueshme</i>	-	-
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit</i>	632,358	98,676
<i>Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesë pjesëmarrëse</i>	177,501	1,268,400
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	5,202,000	2,467,883
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	-	-
<i>Të tjera të pagueshme</i>	<b>6,011,859</b>	<b>3,834,959</b>
<b>8 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>		
	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<i>Shitje e punimeve, sherbimeve</i>	14,589,414	21,513,702
<i>Shitje produkteve gatshme</i>	-	-
<i>Shitje mallrash</i>	-	-
<b>Totali</b>	<b>14,589,414</b>	<b>21,513,702</b>
<b>9 Të tjera shpenzime</b>		
	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<i>Blerje /Shpenzime te tjera</i>	1,320,724	2,828,620
<b>Totali</b>	<b>1,320,724</b>	<b>2,828,620</b>

## Aktive Afatgjata Materiale

	Toka	Ndertesa	Makineri paisje	Mjete transporti	Pajisje Informatike	Pajisje Zyre	TOTALI
<b>Me 31.12.2017</b>							
Vlera Bruto	-	-	-	4,636,062.0	1,020,965.3	861,398.0	<b>6,518,425</b>
Amortizim i akumuluar	-	-	-	2,570,185.0	647,468.0	487,126.0	<b>3,704,779</b>
<b>Vlera kontabel neto</b>	-	-	-	<b>2,065,877.0</b>	<b>373,497.3</b>	<b>374,272.0</b>	<b>2,813,646</b>
Shtesa-Blerjet gjate vittit 2018	-	-	-	31,500	-	-	<b>31,500</b>
Pakesime gjate vittit 2018	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet e amortizimit 2018	-	-	-	413,175.3	99,158.2	74,854.3	<b>587,188</b>
Pakesime amortizimi 2018	-	-	-	-	-	-	-
<b>Me 31.12.2018</b>							
Vlera Bruto	-	-	-	4,636,062	1,052,465	861,398	<b>6,549,925</b>
Amortizim i akumuluar	-	-	-	2,983,360	746,626	561,980	<b>4,291,967</b>
<b>Vlera kontabel neto</b>	-	-	-	<b>1,652,702</b>	<b>305,839</b>	<b>299,418</b>	<b>2,257,953</b>

**ARDAEL SHPK**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

**10 Shpenzime të personelit**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Paga dhe shpërblime	5,914,898	5,722,000
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore	696,245	680,228
<b>Totali</b>	<b>6,611,143</b>	<b>6,402,228</b>

**11 Shpenzime konsumi dhe amortizimi**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	587,188	743,028
<b>Totali</b>	<b>587,188</b>	<b>743,028</b>

**12 Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Qira	520,000	648,000
Mirembajtje dhe riparime	31,798	-
Shpenzime energji, uje	76,529	78,337
Sigurime	220,964	368,441
Shpenzime postare	654,230	802,922
Te tjera sherbime	770,104	1,845,439
Sherbime bankare	71,805	55,847
Taksa, tarifa vendore	45,000	45,000
Tatime te tjera	55,117	-
Shpenz pritje, perfaqesime	82,116	66,683
<b>Totali</b>	<b>2,527,663</b>	<b>3,910,669</b>

**13 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	3,542,696	7,629,157
<i>Shpenzime te pa zbritshme</i>	-	-
Gjoba demshperblime	-	-
Shpenzime te tjera	-	-
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
 <b>Fitimi tatimor</b>	<b>3,542,696</b>	<b>7,629,157</b>
<b>Humbje e mbartur</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
 <b>Fitimi tatushem neto</b>	<b>3,542,696</b>	<b>7,629,157</b>
Tatimi mbi fitimin (15%)	531,404	1,144,374
<b>Fitimi/Humbja e vitit</b>	<b>3,011,292</b>	<b>6,484,783</b>

**ARDAEL SHPK**

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018

---

(Shumat janë shprehur në Lek, përveç rastit kur specifikohet monedha tjetër)

**14 Ngjarje mbas mbylljes së bilancit**

Mbas datës së mbylljes së bilancit nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme e cila kërkon regullime të pasqyrave financiare, apo dhënien e shpjegime të plotësuese rrektto.

